

Standardi Ndërkombëtar i Menaxhimit të cilësisë 2

Rishikimet e Cilësisë së Angazhimit

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I MENAXHIMIT TË CILËSISË 2

RISHIKIMET E CILËSISË SË ANGZHIMIT

(Ka hyre ne fuqi për auditimet dhe rishikimet e pasqyrave financiare për periudhat që kane filluar me datën 15 Dhjetor 2022 ose pas kesaj date, dhe për angazhimet e tjera të sigurisë dhe shërbimet e lidhura, duke filluar nga ose pas datës 15 dhjetor 2022)

PËRMBAJTJA

	Paragrafët
Hyrje	
Objekti i këtij SNMC	1–4
Sistemi i menaxhimit të cilësisë të firmës dhe roli i rishikimeve të cilësisë së angazhimit	5-9
Autoriteti i këtij SNMC	10
Hyrja ne fuqi	11
Objektivi	12
Përkufizimet	13
Kërkesat	
Zbatimi dhe pajtueshmëria me Kërkesat përkatëse	14-16
Emërimi dhe kriteret e përzgjedhjes së rishikuesve të cilësisë së angazhimit	17–23
Kryerja e rishikimi të cilësisë së angazhimit	24–27
Dokumentimi	28–30
Aplikimi dhe materiali tjetër shpjeguese	
Emërimi dhe kriteret e përshtatshmërisë së rishikuesve të cilësisë së angazhimit	A1-A24
Kryerja e rishikimit të cilësisë së angazhimit	A25-A49
Dokumentimi	A50-A53

Standardi ndërkombëtar i menaxhimit të cilësisë (SNMC) 2, *Rishikimet e cilësisë së angazhimit*, duhet të lexohet së bashku me SNM C 1, *Menaxhimi i cilësisë për firmat që kryejnë auditime ose rishikime të pasqyrave financiare, ose angazhime të sigurive të tjera apo shërbime të lidhura me to*.

Hyrje

Objekti i këtij SNMC

1. Ky Standard ndërkombëtar i Menaxhimit të Cilësisë (SNMC) ka si objekt:
 - a) Emërimin dhe kriteret e përshtatshme që duhet të plotësojë rishikuesi i cilësisë; dhe
 - b) Përgjegjësitë e rishikuesit të cilësisë së angazhimit në lidhje me performancën dhe dokumentimin e rishikimit të cilësisë së një angazhimi.
2. Ky SNMC zbatohet për të gjitha angazhimet, për të cilat kërkohet një rishikim i cilësisë, në përputhje me SNMC 1. SNMC 2 është projektuar bazuar në faktin që firmat i nënshtrohen SNMC 1 apo kërkesave kombëtare të menaxhimit të cilësisë, të cilat janë të paktën po aq kërkuuese sa SNMC 1. Ky SNMC duhet të lexohet së bashku me kërkesat përkatëse etike.¹
3. Një rishikim i cilësisë së angazhimit, i kryer në përputhje me këtë SNMC është një përgjigje e përcaktuar, e cila është projektuar dhe zbatuar nga firma në përputhje me SNMC 1. Kryerja e një rishikimi të cilësisë së angazhimit bëhet nga rishikuesi i cilësisë së angazhimit, në emër të firmës², në nivel angazhimi.

Skalabiliteti (zbatimi përpjesëtimor)

4. Natyra, afatet dhe shtrirja e procedurave të rishikimit të cilësisë, të kërkuara nga ky SNMC ndryshojnë në varësi të natyrës dhe rrethanave të angazhimit apo të entitetit. Për shembull, procedurat e rishikimit të cilësisë së angazhimit, ka të ngjarë të mos jene shume të zgjeruara për angazhimet që përfshijnë më pak gjykime të rëndësishme të grupit të angazhimit.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë të firmës dhe roli i rishikimeve të cilësisë së angazhimit

5. SNMC 1 përcakton përgjegjësitë e firmës për sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë dhe kërkon që firma të hartojë dhe zbatojë reagimet e duhura për të trajtuar rreziqet e cilësisë në një mënyrë që bazohet në, dhe i përgjigjet arsyeve të vlerësimeve të dhëna për rreziqet e cilësisë³. Reagimet specifike në SNMC 1 përfshijnë vendosjen e politikave ose procedurave që adresojnë rishikimet e cilësisë së angazhimit në përputhje me këtë SNMC.
6. Firma përgjigjet për hartimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë. Sipas SNMC 1, objektivi i firmës është hartimi, zbatimi dhe vënia në funksionim e një sistemi të menaxhimit të cilësisë së angazhimit për auditimet, rishikimet e pasqyrave financiare ose të angazhimeve të sigurive të tjera apo shërbimeve të lidhura me to që kryhen nga një firmë auditimi, i cili i jep firmës siguri të arsyeshme se:
 - Firma dhe stafi i saj përmbushin përgjegjësitë e tyre në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore e rregullatore dhe, për të kryer angazhimet në përputhje me këto standarde e kërkesa; dhe

¹ Standardi ndërkombëtar i menaxhimit të cilësisë (SNMC) 1 (Me pare Standardi ndërkombëtar për kontrollin e cilësisë 1), Menaxhimi i cilësisë për firmat që kryejnë auditime dhe rishikimet e pasqyrave financiare, ose angazhime të tjera të sigurisë apo shërbime të lidhura me to, paragrafi 34(f)

² SNMC 1, paragrafi 34(f)

³ SNMC 1, paragrafi 26

- Raportet e angazhimit të lëshuara nga firma ose partnerët e angazhimit janë të përshtatshme për rrethanat⁴.
7. Siç shpjegohet në SNMC 1⁵, interesit publik i shërbehet përmes kryerjes në vazhdimësi të angazhimeve cilësore. Angazhimet cilësore arrihen nëpërmjet planifikimit dhe kryerjes së tyre, dhe raportimit mbi to në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore e rregullatore të zbatueshme. Arritja e objektivave të këtyre standardeve dhe respektimi i kërkesave të zbatueshme ligjore ose rregullatore, përfshin ushtrimin e gjykimit profesional dhe, kur është e zbatueshme për angazhimin, ushtrimin e skepticizmit profesional.
 8. Një rishikim i cilësisë së angazhimit është një vlerësim objektiv i gjyqimeve të rëndësishme të bëra nga grupi i angazhimit dhe i përfundimeve të arritura prej tyre. Vlerësimi, nga rishikuesi i cilësisë së angazhimit, i gjyqimeve të rëndësishme kryhet në kontekstin e përmbushjes së standardeve profesionale dhe të kërkesave ligjore e rregullatore të zbatueshme. Megjithatë, një rishikim i cilësisë së angazhimit nuk ka për qëllim të jetë një vlerësim i faktit nëse i gjithë angazhimi është në pajtim me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore e rregullatore të zbatueshme, ose me politikat apo procedurat e firmës.
 9. Rishikuesi i cilësisë së angazhimit nuk është anëtar i grupit të angazhimit. Kryerja e një rishikimi të cilësisë së angazhimit nuk ndryshon përgjegjësitë e partnerit të angazhimit për menaxhimin dhe arritjen e cilësisë së angazhimit, dhe as për drejtimin dhe mbikëqyrjen e anëtarëve të grupit të angazhimit dhe rishikimin e punës së tyre. Rishikuesi i cilësisë së angazhimit nuk kërkohet të sigurojë evidence për të mbështetur opinionin apo përfundimin mbi angazhimin, por ekipi i angazhimit mund të japë evidence shtesë, në përgjigje ndaj çështjeve të ngritura gjatë rishikimit të cilësisë së angazhimit.

Autoriteti i këtij SNMC

10. Ky SNMC përcakton objektivin e firmës për ndjekjen e këtij standardi, si edhe kërkesat që synojnë t'i japin mundësi firmës dhe rishikuesit të cilësisë së angazhimit, për të përmbushur objektivin e deklaruar. Përveç kësaj, ky SNMC përmban udhëzime në formën e aplikimit dhe materialit tjetër shpjegues dhe materialin hyrës, i cili paraqet kontekstin përkatës për një kuptim të duhur të këtij SNMC, dhe përkufizimet e disa termave. SNMC 1⁶ shpjegon termat objektiv, kërkesat, aplikimin dhe materialin tjetër shpjegues, materialin hyrës dhe përkufizimet.

Hyrja në fuqi

11. Ky SNMC ka hyrë në fuqi për:
 - a) Auditimet dhe rishikimet e pasqyrave financiare për periudhat që fillojnë më ose pas datës 15 dhjetor, 2022; dhe
 - b) Angazhimet e tjera të sigurisë dhe të shërbimit e lidhura me to, për periudhat që fillojnë me datën 15 dhjetor 2022 ose pas saj.

⁴ SNMC 1, paragrafi 14

⁵ SNMC 1, paragrafi 15

⁶ SNMC 1, paragrafët 12 dhe A6-A9

Objektivi

12. Objektivi i firmës, nëpërmjet emërimit të një rishikuesi të përshtatshëm të cilësisë së angazhimit, është të kryejë një vlerësim objektiv të gjykimeve të rëndësishme të bëra nga grupi i angazhimit dhe të përfundimeve të arritura prej tyre.

Përkufizimet

13. Për qëllimet e këtij SNM-je termat me poshtë kane këto kuptime:’

- a) Rishikim i cilësisë së angazhimit – Një vlerësim objektiv i gjykimeve të rëndësishme të bëra nga grupi i angazhimit dhe të përfundimeve të arritura prej tyre, i kryer nga rishikuesi i cilësisë së angazhimit, i cili ka përfunduar në datën e raportit të angazhimit ose para kesaj date.
- b) Rishikuesi i cilësisë së angazhimit – Një partner, një individ tjetër në firmë, ose një individ i jashtëm, i emëruar nga firma për të kryer rishikimin e cilësisë së angazhimit.
- c) Kërkesat përkatëse etike - Parimet e etikës profesionale dhe kërkesat etike që janë të zbatueshme për një profesionist kontabël, kur ai kryen rishikimin e cilësisë së angazhimit. Kërkesat përkatëse etike zakonisht përfshijnë dispozitat e nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël, të përfshira ne Kodin Ndërkombëtar të Etikës të Profesionisteve Kontabël (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi IESBA), ne lidhje me auditimet ose rishikimet e pasqyrave financiare, angazhimet e tjera të sigurisë apo shërbimeve të lidhura me to, së bashku me kërkesat kombëtare që janë më kufizuese. (Ref: Para. A12-A15)

Kërkesat

Zbatimi dhe pajtueshmëria me Kërkesat përkatëse

14. Firma dhe rishikuesi i cilësisë së angazhimit duhet të njohin këtë SNMC, përfshirë aplikimin dhe materialin tjetër shpjegues, për të kuptuar objektivin e këtij standardi dhe për të zbatuar ne mënyrën e duhur kërkesat përkatëse.
15. Firma ose rishikuesi i cilësisë së angazhimit, sipas rastit, do të jene ne pajtim me çdo kërkesë të kesaj SNMC-je, përveç nëse kërkesa nuk është e rëndësishme për rrethanat e angazhimit.
16. Zbatimi i duhur i kërkesave pritet të japë një bazë të mjaftueshme për arritjen e objektivit të këtij standardi. Megjithatë, nëse firma ose rishikuesi i cilësisë së angazhimit gjykon se zbatimi i kërkesave përkatëse nuk siguron një bazë të mjaftueshme për arritjen e objektivit të këtij standardi, firma ose rishikuesi i cilësisë së angazhimit, sipas rastit, do të ndërmarrin veprime të mëtejshme për të arritur objektivin.

Emërimi dhe kriteret e përzgjedhjes së rishikuesve të cilësisë së angazhimit

17. Firma do të vendosë politika ose procedura që kërkojnë caktimin e përgjegjësive për emërimin e rishikuesve të cilësisë së angazhimit tek një ose disa individë me kompetenca, aftësi dhe autoritetin e duhur brenda firmës për të përmbushur këtë përgjegjësi. Këto politika apo procedura janë kërkesa që

duhet të plotësojnë individët përgjegjës për emërimin e rishikuesit të cilësisë së angazhimit. (Ref: Para. A1-A3)

18. Firma duhet të vendosë politika ose procedura që përcaktojnë kriteret për përzgjedhjen për t'u emëruar si një rishikues i cilësisë së angazhimit. Këto politika apo procedura do të kërkojnë që rishikuesi i cilësisë së angazhimit të mos jete është anëtar i ekipit të angazhimit, dhe: (Ref: Para. A4)

a) Te ketë kompetencën dhe aftësitë, përfshirë kohën e mjaftueshme dhe autoritetin e duhur për të kryer rishikimin e cilësisë së angazhimit; (Ref: Para. A5-A11)

b) Te respektoje kërkesat përkatëse etike, duke përfshirë ato në lidhje me kërcënimet ndaj objektivitetit dhe pavarësisë së rishikuesit të cilësisë së angazhimit; dhe (Ref: Para. A12-A15)

c) Te veprojë në pajtim me dispozitat e ligjit dhe të rregulloreve, nëse ka të tilla, që përcaktojnë kriteret e përzgjedhjes së rishikuesit të cilësisë së angazhimit. (Ref: Para. A16)

19. Politikat ose procedurat e firmës, të vendosura në përputhje me paragrafin 18(b) trajtojnë gjithashtu, kërcënimet ndaj objektivitetit të krijuara nga një individ që emërohet rishikues i cilësisë së angazhimit, pasi me pare ka shërbyer si partner i angazhimit. Këto politika apo procedura do të specifikojnë një periudhë ndërprerje (cooling - off) prej dy vjetësh, ose një periudhë më të gjatë, nëse duhet, sipas kërkesave përkatëse etike, përpara se partneri i angazhimit të mund të marrë rolin e rishikuesit të cilësisë së angazhimit. (Ref: Para. A17-A18)

20. Firma do të vendosë politika ose procedura të cilat përcaktojnë kriteret për përzgjedhjen e individëve që ndihmojnë rishikuesin e cilësisë së angazhimit. Këto politika apo procedura do të kërkojnë që këta individë të mos jene anëtarë të grupit të angazhimit, dhe:

a) Të kenë kompetencën dhe aftësitë, përfshirë kohën e mjaftueshme, për të kryer detyrat që ju caktohen; dhe (Ref: Para. A19)

b) Te respektojnë kërkesat përkatëse etike, përfshirë kërkesat në lidhje me kërcënimet ndaj objektivitetit dhe pavarësisë së tyre dhe, nëse është e zbatueshme, dispozitat e ligjeve dhe të rregullave. (Ref: Para. A20-A21)

21. Firma vendos politika ose procedura të cilat:

a) Kërkojnë që rishikuesi i cilësisë së angazhimit të marrë përgjegjësinë e përgjithshme për kryerjen e rishikimit të cilësisë së angazhimit; dhe

b) Të adresojë përgjegjësinë e rishikuesit të cilësisë së angazhimit për përcaktimin e natyrës, afatit dhe shtrirjes së drejtimit dhe mbikëqyrjes së individëve që ndihmojnë në shqyrtimin, dhe rishikimin e punës së tyre. (Ref: Para. A22)

Rënia e kërkesave të përzgjedhjes së rishikuesit të cilësisë së angazhimit për të kryer rishikimin e cilësisë së angazhimit

22. Firma do të vendosë politika ose procedura të cilat adresojnë rrethanat në të cilat kriteret e përzgjedhjes së rishikuesit të cilësisë së angazhimit, për të kryer rishikimin e cilësisë së angazhimit, kane pësuar rënie dhe veprimet që do të ndërmerren nga firma, përfshirë procesin për identifikimin dhe emërimin e një zëvendësuesi në këto rrethana. (Ref: Para. A23)
23. Kur rishikuesi i cilësisë së angazhimit bëhet i vetëdijshëm për rrethanat që ulin kriteret për përshtatshmërinë e zgjedhjes së rishikuesit të cilësisë së angazhimit, rishikuesi i cilësisë së angazhimit do të njoftojë individin apo individët e duhur në firmë, dhe: (Ref: Para. A24)
- a) Nëse rishikimi i cilësisë së angazhimit nuk ka filluar, do të refuzojë emërimin për kryerjen e rishikimit të cilësisë së angazhimit; ose
 - b) Nëse rishikimi i cilësisë së angazhimit ka nisur, do të ndërpresë kryerjen e rishikimit të cilësisë së angazhimit.

Kryerja e rishikimi të cilësisë së angazhimit

24. Firma do të vendosë politika ose procedura në lidhje me kryerjen e rishikimit të cilësisë së angazhimit, të cilat do të adresojnë:
- a) Përgjegjësitë e rishikuesit të cilësisë së angazhimit për të kryer procedurat në përputhje me paragrafët 25-26 në kohen e duhur gjatë angazhimit, për të siguruar një bazë të përshtatshme për një vlerësim objektiv të gjykimeve të rëndësishme të bëra nga grupi angazhimit dhe të përfundimeve të arritura prej tyre;
 - b) Përgjegjësitë e partnerit të angazhimit në lidhje me rishikimin e cilësisë së angazhimit, përfshirë faktin që partneri i angazhimit nuk do të lëshojë raportin e angazhimit deri sa të njoftohet nga rishikuesi i cilësisë së angazhimit, në përputhje me paragrafin 27, se rishikimi i cilësisë së angazhimit është i plotë; dhe (Ref: Para. A25-A26)
 - c) Rrethanat kur natyra dhe shtrirja e diskutimeve të grupit të angazhimit me rishikuesin e cilësisë së angazhimit rreth një gjykimi të rëndësishëm, bëhet shkas për një kërcënim ndaj objektivitetit të rishikuesit të cilësisë së angazhimit, dhe veprimet e duhura që duhet të ndërmerren në këto rrethana. (Ref: Para. A27)
25. Për kryerjen e rishikimit të cilësisë së angazhimit, rishikuesi i cilësisë së angazhimit duhet: (Ref: Para. A28-A33)
- (a) Te lexojë dhe të kuptojë informacionin e komunikuar nga: (Ref: Para. A34)
 - (i). Grupi i angazhimit në lidhje me natyrën dhe rrethanat e angazhimit dhe entitetin; dhe
 - (ii). Firma, në lidhje me procesin e monitorimit dhe të korrigjimit të mangësive të firmës, veçanërisht të mangësive të identifikuara që mund të lidhen, ose ndikojnë në fushat që përfshijnë gjykime të rëndësishme të bëra nga grupi i angazhimit.

- (b) Te diskutoje me partnerin e angazhimit dhe, nëse është e zbatueshme, me anëtarët e tjerë të grupit të angazhimit, për çështje të rëndësishme dhe gjykime të rëndësishme të bëra në lidhje me planifikimin, kryerjen dhe raportimin e angazhimit. (Ref: Para. A35-A38)
- (c) Bazuar në informacionin e marrë në (a) dhe (b) me sipër, të shqyrtojë dokumentacionin e angazhimit të zgjedhur, në lidhje me gjykimet e rëndësishme të bëra nga grupi i angazhimit dhe të vlerësojë: (Ref: Para. A39-A43)
 - (i). Bazën ku mbështeten këto gjykime të rëndësishme, duke përfshirë, kur është e zbatueshme për llojin të angazhimit, ushtrimin e skepticizmit profesional nga grupi i angazhimit ;
 - (ii). Nëse dokumentacioni i angazhimit mbështet përfundimet e arritura; dhe
 - (iii). Nëse përfundimet e arritura janë të përshtatshme.
- (d) Për auditimet e pasqyrave financiare, të vlerësoje bazën që ka përdorur partneri i angazhimit për të përcaktuar se janë përmbushur kërkesat e përkatëse etike në lidhje me pavarësinë. (Ref: Para. A44)
- (e) Të vlerësojë nëse është bërë një konsultim i përshtatshëm për çështje të vështira ose të diskutueshme ose për çështjet që kanë të bëjnë me diferenca në opinione dhe për konkluzionet e dalë nga këto konsultime. (Ref: para. A45)
- (f) Për auditimet e pasqyrave financiare, të vlerësoje bazën që ka përdorur partneri i angazhimit për të përcaktuar se përfshirja e tij ka qenë e mjaftueshme dhe e përshtatshme gjatë gjithë angazhimit të auditimit, d.m.th., që partneri i angazhimit ka një bazë për të përcaktuar se gjykimet e rëndësishme të bëra dhe përfundimet e arritura janë të përshtatshme, nisur nga natyra e dhe rrethanat e angazhimit. (Ref: Para. A46)
- (g) Rishikimin:
 - (iv). Për auditimet e pasqyrave financiare, pasqyrat financiare dhe raportin e audituesit mbi këto pasqyra, përfshirë, kur është rasti, përshkrimin e çështjeve kryesore të auditimit; (Ref: Para. A47)
 - (v). Për angazhimet e rishikimit të pasqyrave financiare ose të informacionit financiar dhe raportit të angazhimit mbi këto informacione; ose (Ref: Para. A47)
 - (vi). Për angazhimet e tjera të sigurisë dhe të shërbimeve të lidhura me to, raportin e angazhimit dhe kur është e zbatueshme, informacionin për çështjen që shqyrtohet. (Ref: Para. A48)

26. Rishikuesi i cilësisë së angazhimit duhet të njoftojë partnerin e angazhimit kur rishikuesi ka shqetësime për faktin që gjykimet e rëndësishme të bëra nga grupi i angazhimit, apo përfundimet e arritura, nuk janë të përshtatshme. Nëse zgjidhja e këtyre shqetësimeve nuk e bind rishikuesin e cilësisë së angazhimit, ky i fundit do të njoftojë një individ të përshtatshëm në firmë, duke u shprehur se rishikimi i cilësisë së angazhimit nuk mund të përfundojë. (Ref: Para. A49)

Përfundimi i rishikimit të cilësisë së angazhimit

27. Rishikuesi i cilësisë së angazhimit do të vlerësojë nëse janë përmbushur kërkesat e këtij SNMC-je në lidhje me kryerjen e rishikimit të cilësisë së angazhimit dhe nëse ky rishikim është i plotë. Nëse po, rishikuesi i cilësisë së angazhimit do të njoftojë partnerin e angazhimit se rishikimi i cilësisë së angazhimit është i plotë.

Dokumentimi

28. Firma do të vendosë politika ose procedura, të cilat kërkojnë që rishikuesi i cilësisë së angazhimit të ketë përgjegjësinë për dokumentimin e rishikimit të cilësisë së angazhimit. (Ref: Para. A50)

29. Firma do të vendosë politika ose procedura që kërkojnë dokumentimin e rishikimit të cilësisë së angazhimit në përputhje me paragrafin 30, dhe ky dokumentacion të përfshihet në dosje të bashku me dokumentacionin e angazhimit.

30. Rishikuesi i cilësisë së angazhimit do të vlerësojë nëse dokumentacioni i rishikimit të cilësisë së angazhimit është i mjaftueshëm për t'i dhënë mundësi një profesionisti të praktikës me përvojë, që nuk ka patur lidhje të mëparshme me angazhimin, të kuptojë natyrën, afatin dhe shtrirjen e procedurave të kryera nga rishikuesi i cilësisë së angazhimit dhe, kur është e zbatueshme, nga individët të cilët kanë ndihmuar rishikuesin, dhe përfundimet e arritura në kryerjen e rishikimit. Rishikuesi i cilësisë së angazhimit gjithashtu do të sigurojë se dokumentacioni i rishikimit të cilësisë së angazhimit përfshin: (Ref: Para. A51-A53)

- a) Emrat e rishikuesit të cilësisë së angazhimit dhe të individëve që kanë ndihmuar me rishikimin e cilësisë së angazhimit;
- b) Një identifikim të dokumentacionit të angazhimit të rishikuar;
- c) Bazën për vlerësimin e rishikuesit të cilësisë së angazhimit në përputhje me paragrafin 27;
- d) Njoftimet e kërkuara në përputhje me paragrafët 26 dhe 27; dhe
- e) Datën e përfundimit të rishikimit të cilësisë së angazhimit.

Aplikimi dhe materiali tjetër shpjeguese

Emërimi dhe kriteret e përshtatshmërisë së rishikuesve të cilësisë së angazhimit

Përcaktimi i përgjegjësisë për emërimin e rishikuesve të cilësisë së angazhimit (Ref: Para. 17)

A1. Kompetencat dhe aftësitë e një individi për të përmbushur përgjegjësinë për t'u emëruar si rishikues i cilësisë së angazhimit mund të përfshijë njohuri të përshtatshme në lidhje me:

- Përgjegjësitë e një rishikuesi të cilësisë së angazhimit;
- Kriteret në paragrafët 18 dhe 19 në lidhje me përshtatshmërinë e rishikuesve të cilësisë së angazhimit; dhe

- Natyrën dhe rrethanat e angazhimit ose të entitetit që i nënshtrohet një rishikimi të cilësisë së angazhimit, përfshirë përbërjen e grupit të angazhimit.

A2. Politikat ose procedurat e firmës mund të specifikojnë që individ i përgjegjës për emërimin e rishikuesit të cilësisë së angazhimit të mos jete një anëtar i grupit të angazhimit për të cilin do të kryhet rishikimi i cilësisë së angazhimit. Megjithatë, në rrethana të caktuara (p.sh., në rastin e një firme më të vogël ose të një personi fizik të vetëm), kjo gjë mund të mos jete e mundur dhe emërimi i rishikuesit të cilësisë së angazhimit, kryhet nga një anëtar i grupit të angazhimit.

A3. Firma mund të caktojë më shumë se një individ me përgjegjësinë për caktimin e rishikuesit të cilësisë së angazhimit. Për shembull, politikat ose procedurat e firmës mund të kenë një proces të veçantë për emërimin e rishikuesit të cilësisë së angazhimit për auditimet e entiteteve të listuara, që është i ndryshëm nga caktimi i rishikuesit për auditimet e entiteteve që nuk janë të listuara apo të entiteteve të tjera, d.m.th. me individë të ndryshëm përgjegjës për çdo proces.

Kriteret e përzgjedhjes së rishikuesit të Cilësisë së Angazhimit (Ref: Para. 18)

A4. Në disa rrethana, për shembull, në rastin e një firme më të vogël ose të një personi fizik, praktikues i vetëm, mund të mos ketë asnjë partner apo individ tjetër në firmë, i cili të përmbushë kriterin e përshtatshmërisë për të kryer rishikimin e cilësisë së angazhimit. Në këto kushte, për të kryer rishikimin e cilësisë së angazhimit, firma mund të kontrakttojë ose të marrë shërbimet e individëve nga jashtë firmës. Një individ i jashtëm mund të jetë partner ose punonjës i një firme rrjeti, një strukture ose një organizate brenda rrjetit ku bën pjese firma, ose një ofrues shërbimi i jashtëm. Kur përdoren këta individë, do të zbatohen dispozitat në SNMC 1, të cilat adresojnë kërkesat e rrjetit, shërbimet e rrjetit ose ofruesit e shërbimeve.

Kriteret e përzgjedhjes së rishikuesit të cilësisë së angazhimit

Aftësitë dhe kompetencat, përfshirë kohën e mjaftueshme (Ref: Para. 18(a))

A5. SNMC 1 përshkruan karakteristikat që lidhen me kompetencën, përfshirë integrimin dhe aplikimin e kompetencës teknike, aftësitë dhe zotësitë profesionale, dhe etiken profesionale, vlerat dhe qëndrimet⁷. Çështjet që mund të mbaje parasysh firma për të përcaktuar nëse një individ ka kompetencën e nevojshme për të kryer një rishikim të cilësisë së angazhimit përfshijnë, për shembull:

- Njohjen dhe kuptimin e standardeve profesionale, të kërkesave të zbatueshme ligjore e rregullatore, dhe të politikave ose procedurave të firmës që kanë të bëjnë me angazhimin;
- Njohuritë për sektorin e ekonomisë ku vepron entiteti;
- Një njohje, kuptim dhe përvojë të lidhur me angazhimet e një natyre dhe kompleksiteti të ngjashëm; dhe
- Njohjen dhe kuptimin e përgjegjësiave të rishikuesit të cilësisë së angazhimit në kryerjen dhe dokumentimin e rishikimit të cilësisë së angazhimit, i cili mund të arrihet ose të përmirësohet nëpërmjet marrjes së trajnimit të duhur nga firma.

A6. Kushtet, ngjarjet, rrethanat, veprimet apo mosveprimet që mbahen parasysh nga firma për të përcaktuar nëse një rishikim i cilësisë së angazhimit, është një përgjigje e përshtatshme ndaj një ose

⁷SNMC 1, Paragrafët A88

më shumë rrezeqeve të cilësisë⁸, mund të je në një konsideratë e rëndësishme kur firma përcakton kompetencat dhe aftësitë që kërkohen për të kryer rishikimin e cilësisë së angazhimit për këtë angazhim. Konsiderata të tjera që mund të mbahen parasysh nga firma për përcaktimin nëse rishikuesi i cilësisë së angazhimit ka kompetencat dhe aftësitë, përfshirë kohën e mjaftueshme, të nevojshme për të vlerësuar gjykimet e rëndësishme të bëra nga grupi i angazhimit dhe përfundimet e arritura prej tyre, përfshijnë, për shembull:

- Natyrën e entitetit.
- Specializimin dhe kompleksitetin e sektorit të ekonomisë ose të mjedisit rregullator në të cilin vepron entiteti.
- Shkallë në të cilën angazhimi lidhet me çështjet që kërkojnë ekspertizë të specializuar (p.sh., në lidhje me teknologjinë e informacionit (TI) ose fushat e specializuara të kontabilitetit apo auditimit), ose ekspertizë shkencore dhe ekspertizë inxhinjerike, e cila mund të jenë të nevojshme për disa angazhime të sigurisë. Shiko gjithashtu edhe paragrafin A19.

A7. Për vlerësimin e kompetencës dhe aftësive të një individi që mund të emërohet si rishikues i cilësisë së një angazhimi, konsiderata të vlefshme mund të jene edhe gjetjet që dalin nga veprimtaritë monitoruese të firmës (p.sh., gjetjet nga inspektimi të angazhimeve, në të cilat individi ka qene një anëtar i grupit të angazhimit ose rishikues i cilësisë angazhimit) apo rezultatet e inspektimeve të jashtme.

A8. Mungesa e kompetencës apo aftësive të duhura ndikon në aftësinë e rishikuesit të cilësisë së angazhimit për të ushtruar gjykimin e duhur profesional në kryerjen e rishikimit. Për shembull, një rishikues i cilësisë së angazhimit, të cilit i mungon përvoja përkatëse e sektorit të ekonomisë apo industrisë, mund të mos zotërojë aftësinë ose mund të mos ketë besimin e nevojshëm për të vlerësuar dhe, kur është e përshtatshme, për të sfiduar gjykimet e rëndësishme të bëra dhe ushtrimin e skepticizmit profesional, të grupit të angazhimit për një çështje komplekse, specifike për kontabilitetin ose auditimin në sektorin ekonomik ku vepron entiteti.

Autoriteti i përshtatshëm (Ref: Para. 18(a))

A9. Veprimet në nivel të firmës ndihmojnë në vendosjen e autoritetit të rishikuesit të cilësisë së angazhimit. Për shembull, krijimi i një kulturë respekti për rolin e rishikuesit të cilësisë së angazhimit, ndikon që rishikuesi i cilësisë së angazhimit të ketë me pak presione nga partneri i angazhimit apo nga anëtarë të tjerë të personelit të firmës, të cilët mund të ndikojnë në mënyrë të papërshtatshme në rezultatin e rishikimit të cilësisë së angazhimit. Në disa raste, autoriteti i rishikuesit të cilësisë së angazhimit mund të rritet nga politikat ose procedurat e firmës që adresojnë diferencat në opinione, të cilat mund të përfshijnë veprimet, që rishikuesi i cilësisë së angazhimit mund të ndër marrë kur ka një mosmarrëveshje midis rishikuesit të cilësisë së angazhimit dhe grupit të angazhimit.

A10. Autoriteti i rishikuesit të cilësisë së angazhimit mund të zvogëlohet kur:

- Kultura brenda firmës nxit respektin për autoritet vetëm të personelit në një nivel më të lartë të hierarkisë brenda firmës.

⁸ SNMC 1, Paragrafët A134

- Rishikuesi i cilësisë së angazhimit ka një linjë të raportimit me partnerin e angazhimit, për shembull, kur partneri i angazhimit ka një pozicion udhëheqëse në firmë ose është përgjegjës për përcaktimin dhe kompensimin e rishikuesit të cilësisë së angazhimit.

Konsiderata për sektorin publik

A11. Në sektorin publik, një auditues (p.sh., një Auditues i Përgjithshëm, ose një individ tjetër i kualifikuar në mënyrë të përshtatshme, dhe i emëruar në emër të Audituesit të Përgjithshëm) mund të veprojë në një rol ekuivalent me atë të partnerit të angazhimit me të gjithë përgjegjësitë për auditimet e sektorit publik. Në rrethana të tilla, përzgjedhja e rishikuesit të cilësisë së angazhimit mund të kërkojë shqyrtimin e nevojës për pavarësinë dhe aftësinë e rishikuesit të cilësisë së angazhimit për të bërë një vlerësim objektiv.

Kërkesat përkatëse etike (Ref: Para. 13(c), 18(b))

A12. Kërkesat përkatëse etike që zbatohen kur kryhet një rishikim i cilësisë së angazhimit mund të ndryshojnë, në varësi të natyrës dhe rrethanave të angazhimit ose të entitetit. Disa dispozita të ndryshme të kërkesave përkatëse etike mund të aplikohen vetëm për profesionistët kontabël individuale, siç mund të ishte një rishikues i cilësisë së angazhimit, dhe jo për firmën profesionale.

A13. Kërkesat përkatëse etike mund të përfshijnë kërkesa të veçanta për pavarësinë, të cilat do të aplikoheshin për profesionistët kontabël individuale, siç është një rishikues i cilësisë së angazhimit. Kërkesat përkatëse etike mund të përfshijnë gjithashtu, dispozita që trajtojnë kërcënimet ndaj pavarësisë, të krijuara nga marrëdhënia e gjatë me një klient të auditimit ose me një klient të sigurisë. Zbatimi i kushteve që lidhen me marrëdhënien për një kohë të gjatë me klientin, dallon nga zbatimi i dispozitave të ndërprerjes (cooling -moff) që kërkojnë sipas paragrafit 19, ndonëse edhe kjo dispozite mund të mbahet parasysh.

Kërcënimet ndaj objektivitetit të rishikuesit të cilësisë së angazhimit

A14. Kërcënimet ndaj objektivitetit të rishikuesit të cilësisë së angazhimit mund të krijohen nga një gamë e gjerë faktesh dhe rrethanat. Për shembull:

- Një kërcënim i vetë rishikimit mund të krijohet kur rishikuesi i cilësisë së angazhimit ka qene i përfshirë në gjykimet e rëndësishme të bëra nga grupi i angazhimit, veçanërisht, si partner i angazhimit ose në pozitën e një anëtar tjetër të grupit të angazhimit.
- Një kërcënim i familjaritetit ose i interesit vetjak mund të krijohet kur rishikuesi i cilësisë së angazhimit është një anëtar i ngushtë ose i menjëhershëm i familjes së partnerit të angazhimit ose të një anëtar tjetër të grupit të angazhimit, apo nëpërmjet marrëdhënieve të ngushta personale me anëtarët e grupit të angazhimit.
- Një kërcënim i frikësimit mund të krijohet kur ushtrohet presion real ose i perceptuar mbi rishikuesin e cilësisë së angazhimit (p.sh., kur partneri i angazhimit është një individ agresiv ose dominues, apo kur rishikuesi i cilësisë së angazhimit ka një linjë raportimi direkte me partnerin e angazhimit).

A15. Kërkesat përkatëse etike mund të përfshijnë kërkesat dhe udhëzimet për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar kërcënimet ndaj objektivitetit. Për shembull, Kodi IESBA jep udhëzime specifike, duke përfshirë shembuj të:

- Rrethanave kur mund të krijohen kërcënime ndaj objektivitetit, kur një profesionist kontabël është emëruar si një rishikues i cilësisë së angazhimit;
- Faktorëve që janë të rëndësishëm në vlerësimin e nivelit të këtyre kërcënimeve; dhe
- Veprimeve, përfshirë edhe masat mbrojtëse, që mund t'u bëjnë ballë këtyre kërcënimeve.

Ligji ose rregullat që përcaktojnë kriteret e përzgjedhjes së rishikuesit të cilësisë së angazhimit (Ref: Para. 18(c))

A16. Ligji ose rregullat mund të përshkruajnë kërkesa shtesë në lidhje me kriteret që duhet të përmbushë rishikuesi i cilësisë së angazhimit. Për shembull, në disa juridiksione, rishikuesi i cilësisë së angazhimit mund të kërkohet të zotërojë kualifikime të caktuara ose të jete i licencuar për të qenë në gjendje të kryejë rishikim të cilësisë së angazhimit.

Periodha e ndërprerjes (Cooling-off) për një individ që me pare ka shërbyer si partner i angazhimit (Ref: Para. 19)

A17. Në angazhimet që përsëriten, çështjet për të cilat bëhen gjykime të rëndësishme shpesh janë të njëjta. Për këtë arsye, gjykimet e rëndësishme të bëra në periudhat e mëparshme mund të vazhdojnë të ndikojnë në gjykimet e grupit angazhimit edhe në periudhat pasuese. Aftësia e një rishikuesi të cilësisë së angazhimit për të kryer një vlerësim objektiv të gjykimeve të rëndësishme ndikohet, kur individ i ka qene me pare i përfshirë në këto gjykime si partner i angazhimit. Në rrethana të tilla, është e rëndësishme që të vendosen masat e duhura mbrojtëse për të zvogëluar kërcënimet ndaj objektivitetit, në veçanti, kërcënimin e vetë rishikimit, deri në një nivel të pranueshëm. Prandaj ky SNMC kërkon që firma të përcaktojë politika apo procedura që specifikojnë një periudhë të ndërprerjes së angazhimit, gjatë së cilës partneri i angazhimit nuk ka të drejte për t'u emëruar si rishikues i cilësisë së angazhimit.

A18. Politikat apo procedurat e firmës mund të trajtojnë edhe faktin nëse një periudhë ndërprerje do të ishte ose jo e përshtatshme për një individ tjetër, të ndryshëm nga partneri i angazhimit, përpara se ai të plotësojë kriteret për t'u përzgjedhur dhe emëruar si rishikues i cilësisë së angazhimit. Në lidhje me këtë, firma mund të shqyrtojë natyrën e rolit që ka patur individ i dhe përfshirjen e tij të mëparshme në gjykimet e rëndësishme të bëra mbi angazhimin. Për shembull, firma mund të përcaktojë se një partner angazhimi përgjegjës për kryerjen e procedurave të auditimit mbi informacionin financiar të një komponenti në një angazhim të auditimit të një grupi, mund të mos plotësojë kriteret për t'u emëruar si rishikues i cilësisë së angazhimit të grupit, për shkak të përfshirjes së partnerit të auditimit në gjykimet e rëndësishme që prekin angazhimin e auditimit të grupit.

Rrethanat kur rishikuesi i cilësisë së angazhimit përdor asistentë (Ref: Para. 20-21)

A19. Në disa rrethana, mund të jetë e përshtatshme që rishikuesi i cilësisë së angazhimit të ndihmohet nga një individ ose grup individësh me ekspertizën përkatëse. Për shembull, për të kuptuar disa transaksione të kryera nga entiteti për të ndihmuar rishikuesin e cilësisë së angazhimit të vlerësojë gjykimet e rëndësishme të bëra nga grupi i angazhimit lidhur me këto transaksione mund të nevojiten njohuri shumë të specializuara.

A20. Udhëzimi në paragrafin A14 mund të jetë i dobishëm për firmën kur ajo vendos politika ose procedura që trajtojnë kërcënimet ndaj objektivitetit të individëve që asistojnë rishikuesin e cilësisë së angazhimit.

A21. Kur rishikuesi i cilësisë së angazhimit ndihmohet nga një individ jashtë firmës, përgjegjësitë e asistentit, përfshirë ato që lidhen me pajtueshmërinë me kërkesat përkatëse etike, mund të përcaktohen në kontratë ose me një marrëveshje tjetër midis firmës dhe asistentit.

A22. Politikat ose procedurat e firmës mund të përfshijnë përgjegjësitë e rishikuesit të cilësisë së angazhimit për te:

- Vlerësuar nëse ndihmësit i kuptojnë udhëzimet e tyre dhe nëse puna kryhet në përputhje me metodën e planifikuar për rishikimin e cilësisë së angazhimit; dhe
- Trajtuar çështjet e ngritura nga ndihmësit, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre dhe sipas nevojës, modifikimin e metodës së planifikuar në mënyrë të përshtatshme.

Ulja e kërkesave për zgjedhjen dhe emërimin e rishikuesit të cilësisë së angazhimit për të kryer rishikimin e cilësisë së angazhimit (Ref: Para. 22-23)

A23. Faktorët që për firmën mund të jenë të përshtatshëm për të vlerësuar nëse ka rënie në kriteret për përzgjedhjen e rishikuesit të cilësisë së angazhimit për të kryer rishikimin e cilësisë së angazhimit, përfshijnë:

- Faktin nëse ndryshimet në rrethanat e angazhimit do të ndikojnë që rishikuesi i cilësisë së angazhimit të mos ketë kompetencën dhe aftësitë e duhura për të kryer rishikimin;
- Faktin nëse ndryshimet në përgjegjësitë e tjera të rishikuesit të cilësisë së angazhimit tregojnë se individit nuk ka më kohë të mjaftueshme për të kryer rishikimin; ose
- Njoftimin nga rishikuesi i cilësisë së angazhimit në përputhje me paragrafin 23.

A24. Në rrethanat kur ka ulje në kërkesat për përzgjedhjen e rishikuesit të cilësisë së angazhimit për të kryer rishikimin e cilësisë së angazhimit, politikat ose procedurat e firmës mund të përcaktojnë një proces për të identifikuar personat alternative të përshtatshëm. Politikat apo procedurat e firmës mund të trajtojnë edhe përgjegjësinë e individit të emëruar për të zëvendësuar rishikuesin e cilësisë së angazhimit, për të kryer procedurat e mjaftueshme, në përmbushje të kërkesave të këtij SNMC-je në lidhje me kryerjen e rishikimit të cilësisë së angazhimit. Në rrethana të tilla, këto politika apo procedura mund të adresojnë më tej edhe nevojën për këshillime.

Kryerja e rishikimit të cilësisë së angazhimit (Ref: Para. 24-27)

Përgjegjësitë e partnerit të angazhimit në lidhje me rishikimin e cilësisë së angazhimit (Ref: Para. 24(b))

A25. SNA 220 (i rishikuar)⁹ përcakton kërkesat për partnerin e angazhimit për angazhimet e auditimit për të cilat duhet të kryhet një rishikim i cilësisë së angazhimit, në të cilat përfshihen:

- Përcaktimi nëse është caktuar një rishikues i cilësisë së angazhimit ;
- Bashkëpunimi me rishikuesin e cilësisë së angazhimit dhe informimin e anëtarëve të tjerë të grupit të angazhimit pre përgjegjësisë së tyre për ta bërë këtë rishikim;
- Diskutimi i çështjeve të rëndësishme dhe gjykimeve të rëndësishme që dalin gjatë angazhimit të auditimit, përfshirë ato çështje që identifikohen gjatë rishikimit të cilësisë së angazhimit, me rishikuesin e cilësisë së angazhimit; dhe

⁹ Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 220 (i rishikuar), Menaxhimi i cilësisë për një auditim të pasqyrave financiare, paragrafi 36

- Mos lëshimi i raportit të audituesit deri në datën e përfundimit të rishikimit të cilësisë së angazhimit.

A26. SNAS 3000 (i rishikuar)¹⁰, përcakton gjithashtu, kërkesa për partnerin e angazhimit në lidhje me rishikimin e cilësisë së angazhimit.

Diskutimet midis Rishikuesit të Cilësisë së Angazhimit dhe Grupit të Angazhimit (Ref: Para. 24(c))

A27. Komunikimi i shpeshtë midis grupit të angazhimit dhe rishikuesit të cilësisë së angazhimit gjatë gjithë angazhimit, mund të ndihmojë në kryerjen e një rishikimi efektiv dhe në kohë të cilësisë së angazhimit. Megjithatë, në varësi të kohës dhe shtrirjes së diskutimeve me grupin e angazhimit rreth një gjykimi të rëndësishëm, mund të krijohet një kërcënim ndaj objektivitetit të rishikuesit të cilësisë së angazhimit. Politikat ose procedurat e firmës mund të përcaktojnë veprimet që duhet të ndërmerren nga rishikuesi i cilësisë së angazhimit ose grupi i angazhimit, për të shmangur situatat në të cilat rishikuesi i cilësisë së angazhimit është, ose mund të perceptohet se po i merr vendimet në emër të grupit të angazhimit. Për shembull, në këto rrethana firma mund të kërkojë këshillim rreth gjyqimeve të tilla të rëndësishme me personelin tjetër përkatës, në përputhje me politikat apo procedurat e këshillimit të firmës.

Procedurat që kryen Rishikuesi i Cilësisë së Angazhimit (Ref: Para. 25-27)

A28. Politikat ose procedurat e firmës mund të specifikojnë natyrën, afatin dhe shtrirjen e procedurave që kryen rishikuesi i cilësisë së angazhimit dhe gjithashtu, mund të theksojnë rëndësinë e rishikuesit të cilësisë së angazhimit për të ushtruar gjykim profesional në kryerjen e rishikimit .

Rishikimi i informacioneve financiare historike, paragrafi 36

A29. Afati i procedurave të kryera nga rishikuesi i cilësisë së angazhimit mund të varet nga natyra dhe rrethanat e angazhimit ose entiteti, përfshirë natyrën e çështjeve që i nënshtrohen rishikimit. Rishikimi në kohë i dokumentacionit të angazhimit nga ana e rishikuesit të cilësisë së angazhimit, në gjitha fazat e angazhimit (p.sh., planifikimi, kryerja dhe raportimi) lejon që çështjet të zgjidhen shpejt, duke bindur rishikuesin e cilësisë së angazhimit, në ose para datës së raportit të angazhimit. Për shembull, rishikuesi i cilësisë së angazhimit mund të kryejë procedura në lidhje me të strategjinë e përgjithshme dhe planin e angazhimit në përfundimin e fazës së planifikimit. Kryerja në kohën e duhur e rishikimit të cilësisë së angazhimit, mund të përforcojë ushtrimin e gjykimit profesional dhe, kur është e zbatueshme në varësi të llojit të angazhimit, skepticizmin profesional, nga grupi i angazhimit në planifikimin dhe kryerjen e angazhimit.

A30. Natyra dhe shtrirja e procedurave të rishikimit të cilësisë së angazhimit për një angazhim të caktuar, midis faktorëve të tjerë, mund të varet edhe nga:

- Shkaqet dhe arsyet e vlerësimeve të dhëna për rreziqet e cilësisë¹¹, për shembull, angazhimet e kryera për entitetet në industrinë në zhvillim ose me transaksione komplekse.
- Mangësitë e identifikuara dhe veprimet korrigjuese për adresimin e mangësive të identifikuara, të lidhura me procesin e mbikëqyrjes dhe të korrigjimit që zbaton firma, dhe çdo udhëzim të lidhur

¹⁰ Standardi Ndërkombëtar i Angazhimeve të Sigurisë (SNAS) 3000 (i rishikuar), Angazhimet e sigurisë që nuk janë auditime ose rishikime të informacioneve financiare historike, paragrafi 36

¹¹ SNMC 1, paragrafi A49

me të, të lëshuar nga firma, të cilat mund të tregojnë fushat, ku rishikuesi i cilësisë së angazhimit kërkohet të kryejë procedura më të zgjeruara.

- Komplexiteti i angazhimit.
- Natyra dhe madhësia e entitetit, përfshirë faktin nëse entiteti është i listuar.
- Gjetjet në lidhje me angazhimin, siç janë rezultatet e inspektimeve të ndërmarra nga një autoriteti i mbikëqyrjes së jashtme në një periudhë të mëparshme, ose shqetësime të tjera të ngritura rreth cilësisë së punës së grupit të angazhimit.
- Informacioni i siguruar gjatë kryerjes së procedurave të firmës për pranimin dhe vazhdimin e marrëdhënieve me klientin dhe angazhimet e veçanta.
- Për angazhimet e sigurisë, identifikimi dhe vlerësimi nga grupi i angazhimit dhe reagimi ndaj rreziqeve të anomalisë materiale në angazhim.
- Fakti nëse anëtarët e grupit të angazhimit kanë bashkëpunuar me rishikuesin e cilësisë së angazhimit. Politikat apo procedurat e firmës mund të adresojnë veprimet që kryen rishikuesi i cilësisë së angazhimit, në rrethanat kur grupi i angazhimit nuk ka bashkëpunuar me rishikuesin e cilësisë së angazhimit, për shembull, duke informuar një individ të përshtatshëm në firmë, në mënyrë që të mund të ndërmerret veprim i duhur për të zgjidhur çështjen.

A31. Natyra, afati dhe shtrirja e procedurave të rishikuesit të cilësisë së angazhimit mund të ketë nevojë të ndryshojë bazuar në rrethanat që ndeshen gjatë kryerjes së rishikimit të cilësisë së angazhimit.

Konsideratat për auditimin e grupit

A32. Kryerja e një rishikimi të cilësisë së angazhimit për një auditim të pasqyrave financiare të grupit mund të përfshijë konsiderata shtesë për individin që emërohet si rishikues i cilësisë së angazhimit për auditimin e grupit, në varësi të madhësisë dhe kompleksitetit të grupit. Paragrafi 21(a) përcakton se politikat ose procedurat e firmës duhet të kërkojnë që rishikuesi i cilësisë së angazhimit të marrë përgjegjësinë e përgjithshme për performancën e rishikimit të cilësisë së angazhimit. Duke vepruar në këtë mënyrë, për auditimet e entiteteve të mëdha dhe shume komplekse, rishikuesi i cilësisë së angazhimit të grupit mund të ketë nevojë të diskutojë për çështje dhe gjykime të rëndësishme me anëtarët kryesore të grupit të angazhimit që nuk janë anëtarë të grupit të angazhimit të grupit (p.sh., me ata që janë përgjegjës për kryerjen e procedurave të auditimit të informacionit financiar të një komponenti). Në këto rrethana, rishikuesi i cilësisë së angazhimit mund të ndihmohet nga individët në përputhje me paragrafin 20. Kur rishikuesi i cilësisë së angazhimit për kontrollin e grupit përdor asistentet, ai mund të bazohet në udhëzimin në paragrafin A22.

A33. Në disa raste, një rishikim i cilësisë së angazhimit mund të caktohet për një auditim të entiteti ose të një njësie biznesi, që është pjesë e një grupi, për shembull, kur një auditim i tillë kërkohet nga ligji, rregulli apo për arsye të tjera. Në këto kushte, komunikimi midis rishikuesit të cilësisë së angazhimit për auditimin e grupit dhe rishikuesit të cilësisë së angazhimit për auditimin e atij entiteti ose njësie biznesi, mund të ndihmojë rishikuesin e cilësisë së angazhimit të grupit, në përmbushjen e përgjegjësiave në përputhje me paragrafin 21(a). Për shembull, rasti kur entiteti ose njësia e biznesit është identifikuar si një komponent për qëllimet e auditimit të grupit dhe gjykimet e rëndësishme lidhur me auditimin e grupit janë bërë në nivelin e komponentit.

Informacione të komunikuar nga Grupi i Angazhimit dhe Firma (Ref: Para. 25(a))

A34. Njohja e informacionit të komunikuar nga grupi i angazhimit dhe firma në përputhje me paragrafin 25(a) mund të ndihmojë rishikuesin e cilësisë së angazhimit për të kuptuar gjykimet e rëndësishme për angazhimin, të cilat mund të parashikoheshin. Një kuptim i tillë mund t'i japë rishikuesit të cilësisë së angazhimit një bazë të duhur për diskutimet me grupin e angazhimit lidhur me çështjet dhe gjykimet e rëndësishme të bëra në planifikimin, kryerjen dhe raportimin e angazhimit. Për shembull, një mangësi e identifikuar nga firma mund të lidhet me një mangësi të rëndësishme në gjykimet e bëra nga grupet e tjera të angazhimit për disa çmuarje kontabël në një sektor të veçantë të ekonomisë. Në këtë rast, një informacion i tillë mund të jetë i përshtatshëm për gjykimet e rëndësishme të bëra mbi angazhimin në lidhje me këto çmuarje kontabël, dhe për këtë arsye, mund t'i sigurojë rishikuesit të cilësisë së angazhimit një bazë për diskutimet me grupin e angazhimit në përputhje me paragrafin 25(b).

Çështje të rëndësishme dhe gjykime të rëndësishme (Ref: Para. 25(b)–25(c))

A35. SNA 220 (i rishikuar)¹² kërkon që për auditimet e pasqyrave financiare, partneri i angazhimit të shqyrtojë dokumentacionin e auditimit në lidhje me çështje të rëndësishme¹³ dhe gjykime të rëndësishme, përfshirë ato që lidhen me çështjet e vështira ose të diskutueshme, të identifikuara gjatë angazhimit dhe përfundimeve të arritura.

A36. Për auditimet e pasqyrave financiare, SNA 220 (i rishikuar)¹⁴ jep shembuj të gjykimeve të rëndësishme që mund të identifikohen nga partneri i angazhimit lidhur me strategjinë e përgjithshme të auditimit dhe planin e auditimit për ndërmarrjen e angazhimit, ekzekutimin e angazhimit dhe përfundimet e përgjithshme të arritura nga grupi i angazhimit.

A37. Për angazhime të tjera, të ndryshme nga auditimet e pasqyrave financiare, gjykimet e rëndësishme të bëra nga grupi i angazhimit mund të varen nga natyra dhe rrethanat e angazhimit ose entiteti. Për shembull, në një angazhim sigurie të kryer në përputhje me SNAS 3000 (i rishikuar), vlerësimi nga grupi i angazhimit nëse kriteret për t'u aplikuar në përgatitjen e informacione të entitetit janë të përshtatshme për angazhimin, mund të përfshijnë ose kërkojnë gjykim të rëndësishëm.

A38. Gjatë kryerjes së rishikimit të cilësisë së angazhimit, rishikuesi i cilësisë së angazhimit mund të bëhet i vetëdijshëm për fusha të tjera ku nga grupi i angazhimit parashikohen të bëhen gjykime të rëndësishme, për të cilat mund të nevojiten informacione të mëtejshme rreth procedurave të kryera nga grupi i angazhimit ose në lidhje me bazën për përfundimet e arritura. Në këto rrethana, diskutimet me rishikuesin e cilësisë së angazhimit mund të zbulojnë nevojën që grupi i angazhimit të arrijë në përfundimin se duhet të kryhen procedura shtese.

A39. Informacioni i marrë në përputhje me paragrafët 25(a) dhe 25(b), dhe rishikimi i dokumentimit të angazhimit të zgjedhur, ndihmon rishikuesin e cilësisë së angazhimit për të vlerësuar bazën që ka përdorur grupi i angazhimit në bërjen e gjykimeve të rëndësishme. Konsiderata të tjera që mund të jenë të përshtatshme për vlerësimin e rishikuesit të cilësisë së angazhimit përfshijnë, për shembull:

- Vigjilencën ndaj ndryshimeve në natyrën dhe rrethanat e angazhimit ose të entitetit, të cilat mund të rezultojnë në ndryshime në gjykimet e rëndësishme të bëra nga grupi i angazhimit ;

¹² SNA 220 (I rishikuar), paragrafi 31

¹³ SNA 230, Dokumentimi i auditimit, paragrafi 8(c)

¹⁴ SNA 220 (I rishikuar), paragrafi A92

- Paanshmërinë nga grupi i angazhimit kur vlerësohen përgjigjet; dhe
- Ndjekjen e mospërputhjeve të identifikuar gjatë rishikimit të dokumentacionit të angazhimit, ose përgjigjeve jo koherente të grupit të angazhimit ndaj pyetjeve në lidhje me gjykimet e rëndësishme të bëra.

A40. Politikat ose procedurat e firmës mund të specifikojnë dokumentacionin e angazhimit që do të shqyrtohet nga rishikuesi i cilësisë së angazhimit. Përveç kësaj, këto politika apo procedura mund të tregojnë se rishikuesi i cilësisë së angazhimit ushtron gjykim profesional për zgjedhjen e dokumentacionit shtesë të angazhimit që do të shqyrtohet lidhur me gjykimet e rëndësishme të bëra nga grupi i angazhimit.

A41. Diskutimet rreth gjykimeve të rëndësishme me partnerin e angazhimit dhe nëse është e zbatueshme, me anëtarët e tjerë të grupit të angazhimit, së bashku me dokumentacionin e grupit të angazhimit, mund të ndihmojnë rishikuesin e cilësisë së angazhimit, në vlerësimin e ushtrimit të skepticizmit profesional, kur është i zbatueshëm për angazhimin, nga grupi i angazhimit në lidhje me këto gjykime të rëndësishme.

A42. Për auditimet e pasqyrave financiare, SNA 220 (i rishikuar)¹⁵ jep shembuj të pengesave që mund të krijohen në ushtrimin e skepticizmit profesional në nivel angazhimi, paragjykimet e pavetëdijshme të audituesit, të cilat mund të pengojnë ushtrimin e skepticizmit profesional dhe veprimet e mundshme, që grupi i angazhimit mund të kryejë për të lehtësuar pengesat në ushtrimin e skepticizmit profesional në nivel angazhimi.

A43. Për auditimet e pasqyrave financiare, kërkesat dhe materiali përkatës shpjegues pre aplikimin në SNA 315 (i rishikuar 2019),¹⁶ SNA 540 (i rishikuar)¹⁷ dhe SNA të tjera, japin edhe shembuj të fushave në një auditim, ku audituesi ushtron skepticizëm profesional, ose shembuj se ku dokumentimi i përshtatshëm mund të ndihmojë në dhënien e evidencës për mënyrën se si audituesi e ka ushtruar skepticizmin profesional. Ky udhëzim mund të ndihmojë gjithashtu, rishikuesin e cilësisë së angazhimit, në vlerësimin e ushtrimit të skepticizmit profesional nga grupi i angazhimit.

A janë plotësuar kërkesat përkatëse etike lidhur me pavarësinë (Ref: Para. 25(d))

A44. SNA 220 (i rishikuar)¹⁸ kërkon që partneri i angazhimit, para se të lëshojë raportin e audituesit, të marrë përgjegjësi për të përcaktuar nëse janë përmbushur kërkesat përkatëse etike, përfshirë ato që lidhen me pavarësinë.

Konsultimet për çështje të vështira, të diskutueshme ose për çështje që kanë të bëjnë me diferencat në opinion (Ref: Para. 25(e))

A45. SNMC 1¹⁹ trajton konsultimin për çështje të vështira ose të diskutueshme dhe diferencat në opinion brenda grupit të angazhimit, ose midis grupit të angazhimit dhe rishikuesit të cilësisë së angazhimit apo individëve që kryejnë veprimtari brenda sistemit të menaxhimit të cilësisë së firmës.

¹⁵ SNA 220 (I rishikuar), paragrafët A34-A36

¹⁶ SNA 315 (I rishikuar, 2019), Identifikimi dhe vlerësimi i Rreziqeve të anomalisë materiale, paragrafi A23

¹⁷ SNA 540 (I rishikuar), Auditimi i çmuarjeve kontabël dhe shënimeve shpjeguese të lidhura me to, paragrafi A11

¹⁸ SNA 220 (I rishikuar), paragrafi 21

¹⁹ SNMC 1, paragrafët 31(d), 31(e) dhe A79-A82

Përfshirja e mjaftueshme dhe e përshtatshme në angazhim e partnerit të angazhimit (Ref: Para. 25(f))

A46. SNA 220 (i rishikuar)²⁰ kërkon që partneri i angazhimit, para se të lëshojë (t'i vendosë datën) raportin e audituesit, të provojë se përfshirja e tij ka qenë e mjaftueshme dhe e përshtatshme gjatë gjithë angazhimit të auditimit, fakt që tregon se partneri i angazhimit ka bazën e nevojshme për të vlerësuar nëse gjykimet e rëndësishme të bëra dhe përfundimet e arritura janë të përshtatshme, duke pasur parasysh natyrën dhe rrethanat e angazhimit. SNA 220 (i rishikuar)²¹ tregon, gjithashtu, se dokumentimi i përfshirjes së partnerit të angazhimit mund të kryhet në mënyra të ndryshme. Diskutimet me grupin e angazhimit dhe rishikimi i këtij dokumentimi të angazhimit, mund të ndihmojnë rishikuesin e cilësisë së angazhimit të vlerësojë bazën e partnerit të angazhimit mbi të cilën përcaktohet se përfshirja e partnerit të angazhimit ka qenë e mjaftueshme dhe e përshtatshme.

Rishikimi i pasqyrave financiare dhe raporteve të angazhimit (Ref: Para. 25(g))

A47. Për auditimet e pasqyrave financiare, rishikimi nga rishikuesi i cilësisë së angazhimit, i pasqyrave financiare dhe raportit të audituesit mbi këto pasqyra, mund të përfshijë vlerësimin e faktit nëse paraqitja dhe dhënia e shpjegimeve për çështjet që kanë të bëjnë me gjykimet e rëndësishme të grupit të angazhimit, janë në koherencë me kuptimin që ka rishikuesi i cilësisë së angazhimit për këto çështje bazuar në rishikimin e dokumentacionit të angazhimit të zgjedhur, dhe me diskutimet me grupin e angazhimit. Kur rishikon pasqyrat financiare, rishikuesi i cilësisë së angazhimit mund të vihet në dijeni edhe të fushave, ku grupi i angazhimit parashikohet të bëjë gjykime të rëndësishme, për të cilat mund të kërkojnë informacione të mëtejshme rreth procedurave ose konkluzioneve të grupit të angazhimit. Udhëzimi në këtë paragraf zbatohet edhe për të rishikuar angazhimet dhe raportin përkatës të angazhimit.

A48. Për angazhimet e tjera të sigurisë dhe shërbimet e lidhura me to, rishikimi nga rishikuesi i cilësisë së angazhimit, i raportit të angazhimit dhe, kur është e zbatueshme, i informacionit për çështjen në fjalë, mund të përfshijë vlerësime apo konsiderata të ngjashme me ato të përshkruara në paragrafin A47 (p.sh., në qoftë se paraqitja apo përshkrimi i çështjeve që kanë të bëjnë me gjykimet e rëndësishme të bëra nga grupi i angazhimit janë në koherencë me kuptimin e rishikuesit të cilësisë së angazhimit bazuar në procedurat e kryera në lidhje me rishikimin).

Shqetësimet e pazgjidhura të rishikuesit të cilësisë së angazhimit (Ref: Para. 26)

A49. Politikat ose procedurat e firmës mund të specifikojnë individin në firmë, i cili duhet njoftuar nëse rishikimi i cilësisë së angazhimit ka shqetësime/çështje të pazgjidhura, që tregojnë se gjykimet e rëndësishme të grupit të angazhimit ose përfundimet e arritura prej tij, nuk janë të përshtatshme. Ky ose këta individë mund të përfshijë individin e caktuar përgjegjës për përzgjedhjen dhe emërimin e rishikuesit të cilësisë së angazhimit. Në lidhje me këto shqetësime të pazgjidhura, politikat apo procedurat e firmës mund të kërkojnë kryerjen e konsultimeve brenda ose jashtë firmës (p.sh., me një organizëm profesional ose rregullator).

Dokumentimi (Ref: para. 28-30)

²⁰ SNA 220 (I rishikuar), paragrafi 40(a)

²¹ SNA 220 (I rishikuar), paragrafi A118

A50. Paragrafët 57 deri 60 të SNMC 1 trajtojnë dokumentacionin e firmës për sistemin e saj të menaxhimit të cilësisë. Prandaj, një rishikim i cilësisë së angazhimit, i kryer në përputhje me këtë SNMC, i nënshtrohet kërkesave të dokumentimit në SNMC 1.

A51. Forma, përmbajtja dhe shtrirja e dokumentimit të rishikimit të cilësisë së angazhimit mund të varet nga faktorë të tillë si:

- Natyra dhe kompleksiteti i angazhimit;
- Natyra e entitetit;
- Natyra dhe kompleksiteti i çështjeve që i nënshtrohen rishikimit të cilësisë së angazhimit; dhe
- Shkalla e dokumentacionit të angazhimit të rishikuar.

A52. Performanca dhe njoftimi i përfundimit të rishikimit të cilësisë së angazhimit mund të dokumentohet në disa mënyra. Për shembull, rishikuesi i cilësisë së angazhimit mund të dokumentojë rishikimin e dokumentacionit të angazhimit në mënyrë elektronike në një aplikacion në TI, për kryerjen e angazhimit. Në mënyrë alternative, rishikuesi i cilësisë së angazhimit mund të dokumentojë rishikimin nëpërmjet një memorandum. Procedurat e rishikimit të cilësisë së angazhimit mund të dokumentohen gjithashtu, në mënyra të tjera, për shembull, në minutat e diskutimeve të grupit të angazhimit ku ka qene i pranishëm rishikuesi i cilësisë së angazhimit.

A53. Paragrafi 24(b) kërkon që politikat ose procedurat e firmës të mos e lejojnë partnerin e angazhimit, të lëshojë raportin e angazhimit përpara përfundimit të rishikimit të cilësisë së angazhimit, që përfshin zgjidhjen e çështjeve të ngritura nga rishikuesi i cilësisë së angazhimit. Me kusht që janë përmbushur të gjitha kërkesat me në lidhje me kryerjen e rishikimit të cilësisë së angazhimit, dokumentimi i rishikimit mund të finalizohet edhe pas datës së raportit të angazhimit, por përpara sistemit përmbledhës të dosjes përfundimtare të angazhimit. Megjithatë, politikat apo procedurat e firmës mund të specifikojnë që dokumentacioni i rishikimit të cilësisë së angazhimit të finalizohet në datën ose para datës së raportit të angazhimit.